

# **TERMA REFERENCE**

**ZBATIMI I MARRËVESHJES KUADËR PËR SISTEMIM ASFALTIM TË  
RRUGËVE NË TERRITORIN E BASHKISË TIRANË**

**Tiranë, 2026**

## 1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

**Objekti:** Zbatimi i punimeve për sistemim, rikonstrukcion, rehabilitim dhe asfaltim të rrugëve dhe segmenteve rrugore në territorin administrativ të Bashkisë Tiranë, në përputhje me nevojat e identifikuar nga Autoriteti Kontraktor dhe urdhrat/punët konkrete të dhëna gjatë periudhës së Marrëveshjes Kuadër.

**Forma e zbatimit:** Marrëveshje Kuadër dhe kontrata/urdhra përkatës për realizimin e punimeve, sipas kushteve të përcaktuara në dokumentet e prokurimit dhe Marrëveshjen Kuadër. Punimet do të realizohen në zona të ndryshme të territorit të Bashkisë Tiranë, sipas kërkesave dhe prioriteteve dhe projekteve të vena në dispozicion nga Bashkia Tiranë..

## 2. QËLLIMI I PUNIMEVE

Qëllimi i punimeve është përmirësimi i gjendjes teknike dhe funksionale të rrjetit rrugor në territorin e Bashkisë Tiranë, nëpërmjet:

- sistemimit dhe rehabilitimit të segmenteve rrugore ekzistuese;
- rikonstrukcionit të shtresave rrugore të dëmtuara;
- realizimit të shtresave të reja asfaltike;
- eliminimit të gropave, deformimeve dhe dëmtimeve të sipërfaqes rrugore;
- përmirësimit të parametrave të drenazhimit të rrugës;
- rehabilitimit të pjesëve të dëmtuara të trupit të rrugës;
- përmirësimit të kushteve të qarkullimit dhe sigurisë rrugore;
- rikthimit në gjendjen funksionale të segmenteve rrugore pas ndërhyrjeve nëntokësore nga operatorë të ndryshëm;
- realizimit të punimeve të tjera ndihmëse të nevojshme për përfundimin e plotë dhe funksional të ndërhyrjes.

## 3. FUSHA E PUNIMEVE

Në varësi të gjendjes së objektit dhe kërkesave të Autoritetit Kontraktor, punimet mund të përfshijnë, por nuk kufizohen në:

### 3.1 Punime përgatitore

- mobilizimin e kantierit;
- verifikimin e gjurmës dhe kufijve të ndërhyrjes;
- rilevimin dhe verifikimin e gjendjes ekzistuese;
- piketimin;
- sigurimin dhe organizimin e zonës së punimeve;
- vendosjen e sinjalistikës së përkohshme;
- menaxhimin e trafikut gjatë punimeve;
- pastrimin e zonës së punimeve.

### 3.2 Prishje dhe heqje

- frezimin e shtresave asfaltike ekzistuese;
- prishjen e shtresave të dëmtuara;
- heqjen e materialeve të papërshtatshme;
- ngarkimin, transportin dhe depozitimin e materialeve të dala nga prishjet në vendet e autorizuar;

- pastrimin e sipërfaqeve pas frezimit.

### **3.3 Punime dheu dhe bazamenti**

Sipas nevojës së përcaktuar për çdo segment:

- gërmime;
- mbushje;
- sistemim dhe profilim të tabanit;
- përmirësim të nënshtresës;
- furnizim, shtrirje dhe ngjeshje të materialeve granulare;
- realizim ose rehabilitim të shtresës bazë;
- stabilizim të zonave të dobëta të rrugës.

### **3.4 Punime asfaltike**

Punimet asfaltike mund të përfshijnë:

- furnizimin dhe transportin e materialit asfaltik;
- shtresën lidhëse;
- shtresën e konsumit;
- asfaltimin e plotë ose të pjesshëm të segmentit;
- asfaltimin pas punimeve të rrjeteve nëntokësore;
- realizimin e shtresave me trashësi sipas projektit, specifikimeve teknike dhe udhëzimeve të Mbikëqyrësit të Punimeve;
- ngjeshjen mekanike të shtresave;
- trajtimin e fugave dhe bashkimeve;
- përpunimin e skajeve dhe lidhjeve me sipërfaqet ekzistuese.

Trashësitë dhe tipologjia e shtresave asfaltike do të përcaktohen për çdo ndërhyrje në bazë të projektit, gjendjes së rrugës, ngarkesës së trafikut, rezultateve të verifikimeve teknike.

### **3.5 Punime drenazhimi**

Kur kërkohet nga gjendja e objektit:

- pastrimi dhe rehabilitimi i kanaleve;
- ndërtimi ose riparimi i pusetave;
- ndërtimi/riparimi i shkarkimeve të ujërave sipërfaqësore;
- vendosja e elementeve të mbledhjes së ujërave;
- rregullimi i kuotave të kapakëve të pusetave;
- realizimi i lidhjeve me sistemin ekzistues të drenazhimit.

### **3.6 Punime në bordura dhe trotuare**

Në varësi të nevojës:

- prishje dhe zëvendësim bordurash;
- vendosje bordurash të reja;
- rregullim kuotash;
- riparim dhe sistemim trotuarësh;
- riparim i rampave dhe elementeve të aksesueshmërisë;

- rikthim në gjendje të mëparshme të elementeve të dëmtuara nga punimet.

### **3.7 Punime pas përfundimit të asfaltimit**

Kontraktori është përgjegjës për:

- pastrimin e sipërfaqes;
- largimin e materialeve të tepërta;
- pastrimin e pusëve dhe elementeve të drenazhimit;
- rregullimin e skajeve të asfaltit;
- lidhjen e sipërfaqes së re me atë ekzistuese;
- rikthimin e zonave të prekura nga punimet;
- sinjalistikën horizontale dhe elemente të tjera, kur parashikohen në preventivin e ndërhyrjes.

### **4. Projekti parashikon:**

Për çdo ndërhyrje do të përcaktohet:

1. vendndodhjen e objektit;
2. gjatësinë dhe gjerësinë e segmentit;
3. gjendjen ekzistuese;
4. natyrën e ndërhyrjes;
5. volumet e pritshme;
6. shtresat dhe parametrat teknikë;
7. afatin e realizimit;
8. vlerën e punimeve, sipas çmimeve të përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër dhe dokumentacionit përkatës.